Programi për Menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor 2018-2022



Prishtinë, 2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA E KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

Programi për Menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor 2018-2022

Prishtinë 2017

Në përputhje me Nenin 1 pika 6, dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2016 për Sistemin e Informimit Mjedisor, në përputhje me nenin 52 të Ligjit nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e saj, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka përgatitur "Programin për Menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor të Republikës së Kosovës 2018-2022".

Përmbajtja

1. Hyrje 5
1.1. Qëllimi, objektivat dhe përmbajtja e programit për menaxhimin e SIM 5
1.2. Parimet themelore për mënyrën e mbajtjes dhe mirëmbajtjes së programit për menaxhimin e SIM 6
1.3. Rëndësia e SIM 7
2. Baza ligjore për SIM 9
3. Struktura dhe organizimi i SIM 14
3.1. Grupet themelore të SIM 14
3.2. Të dhënat dhe informatat për SIM 16
4. Palët e interesit 22
4.1. Roli i AMMK në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e SIM 22
4.2. Institucionet prodhuese të të dhënave mjedisore 23
4.3. Shfrytëzuesit e të dhënave të SIM 26
5. Ndërlidhja me sisteme tjera informative dhe burimet aktuale të të dhënave për SIM 28
5.1. Ndërlidhja me Sistemet tjera Informative 28
5.2. Burimet aktuale elektronike të të dhënave për SIM 29
6. Aktivitetet për Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e SIM 32
6.1. Vlerësimi i nevojave 32
7. Shtojcat 34
7.1. Struktura skematike e SIM 34
7.2. Lista e shkurtesave 35
7.3. Lista e tabelave 37

1. Hyrje

Programi për menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor të Republikës së Kosovës për periudhën 2018-2022 (në vazhdim të dokumentit Programi për menaxhimin e SIM), është dokument i përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që ka ky institucion dhe si obligim ligjor që del nga Udhëzimi Administrativ për Sistemin Informativ Mjedisor.

Programi për menaxhimin e SIM, është një nga dokumentet bazike operative për funksionalizimin dhe menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor dhe hartimi i tij është I mbështetur në nenin 6 pika 1 të Udhëzimi Administrativ për Sistemin Informativ Mjedisor dhe nenit 7 të këtij udhëzimi dhe në nenin 52 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

Dokumenti ka marrë për bazë edhe akte tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë funksionimin e Sistemit Informativ Mjedisor, procesin e prodhimit dhe përpunimit të të dhënave mjedisore për sektorë të caktuar mjedisor si dhe dhe përgjegjësitë e institucioneve relevante sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Ky dokument ka marrë për bazë po ashtu edhe dispozitat ligjore që dalin nga ligjet tjera relevante si Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (nenet 52 dhe 60), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (neni 72), Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (nenet 25 dhe 26), Ligji për Mbeturinat (neni 14), Ligji nr. 04/L-197 për kemikate (neni 15), Ligji për Ujërat e Kosovës (neni 81) dhe Ligji Nr. 02/L-102 për mbrojtje nga zhurma (neni 9).

1.1. Qëllimi, objektivat dhe përmbajtja e programit për menaxhimin e SIM

Qëllimi primar i këtij programi është të mundësojë: mbledhjen, përpunimin, shkëmbimin dhe shfrytëzimit e të dhënave për gjendjen e mjedisit në Republikën e Kosovës, përmes një sistemi modern dhe efikas në nivelin nacional, që do të ofrojë një pasqyre reale të gjendjes së mjedisit dhe problemeve kryesore mjedisore.

Përmes këtij sistemi po ashtu do të mundësohet përcjellja e gjendjes së mjedisit dhe trendëve të zhvillimeve mjedisore, analiza, vlerësimi dhe raportimi real për gjendjen e mjedisit në nivel vendi me qëllim të hartimit dhe miratimit të vendimeve strategjike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për sektorin e mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga ky sistem do të sigurohen edhe të dhëna dhe analiza të nevojshme mjedisore edhe në kuadër të përmbushjes së obligimeve dhe standardeve mjedisore në procesin e integrimeve evropiane dhe bashkëpunimit me institucionet mjedisore të Bashkimit Evropian.

Objektivat kryesore të dokumentit janë:

- Avancimi i sistemit informativ mjedisor dhe digjitalizimi i tij;
- Përmirësimi i sistemit për monitorimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit përmes lehtësimit të procesit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave;
- Përmirësimi i informimit të politkëbërsve, publikut të gjerë dhe grupeve tjera me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe vlerësimit më të mirë të nevojave për ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Përmbajtja e Programit për menaxhimin e SIM është e përcaktuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrative për SIM, ku është e specifikuar që programi për menaxhimin e SIM duhet të përmbajë:

- ✓ organizimin, mënyrën e mbajtjes dhe mirëmbajtjen së SIM.
- ✓ listën e institucioneve që obligohen për dhënien e informative dhe mënyrën e dorëzimit të të dhënave sipas seksioneve tematike dhe nën-seksioneve përkatëse,
- ✓ mënyra dhe afatet kohore për dorëzimin e të dhënave dhe informatave për mjedisin,
- ✓ mënyrën e shfrytëzimit të të dhënave dhe informatave për mjedisin,
- ✓ vlerësimi i burimeve të nevojshme.
- ✓ masat dhe veprimet për seksionet tematike dhe nën-seksionet përkatëse.

1.2. Parimet themelore për mënyrën e mbajtjes dhe mirëmbajtjes së programit për menaxhimin e SIM

Menaxhimi dhe administrimi me Sistemin Informativ Mjedisor do të jetë i bazuar mbi këto parime themelore.

- **Siguria** - Masat për mbrojtjen maksimale - konfidencialitetin e materialeve dhe dokumenteve, aplikimi i sigurisë së të dhënave, kontrollit dhe sigurisë së qasjes;
- **Kontrolli** - I organizuar në mënyrë hierarkike dhe i shpërndarë për të mbështetur shërbimet dhe punët- nga niveli qendror deri tek niveli më i ulët.
- **Thjeshtësia -** Strukturë funksionale dhe e thjeshtëzuar- Përmbajtje logjike e temave prioritare dhe kategorive të shërbimeve.
- **Transparenca -** Monitorimi transparent i proceseve dhe procedurave - statusi i të dhënave të përdoruesit do të jetë në dispozicion për një periudhë të mëparshme, si dhe për gjendjen aktual të informatave të vetë statusit.
- **Përdorimi -** Të përdoret nga grupe të ndryshme të përdoruesve - persona fizikë, personat juridikë, organet e administratës publike.

- **Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria** - Mundësia e një ndryshim të thjeshtë dhe të shpejtë të strukturës dhe përmbajtjes bazuar ne metodën e ekranit.
- **I personalizuar dhe në shërbim të të gjithëve -** Mundësi për të ofruar shërbim të personalizuar elektronike dhe raportimin personal për çështje të rëndësishme për çdo individ, varësisht nga kërkesat e tyre, pa marrë parasysh a është një person fizik, person juridik ose punonjës i administratës publike.
- **Në një dritare -** Të gjitha informatat e nevojshme dhe komunikimit për nevojat e çdo përdoruesi të kenë mundësinë për të qenë të qasshme në mënyrë të centralizuar dhe elektronike.
- **Në çdo kohë, në çdo vend -** Disponushmëria dhe sigurimi i shërbimit për përdoruesit në çdo kohë nga çdo vend.
- **I qasshëm -** Mundësia e lidhjes së portalit me të gjitha sistemet e informacionit dhe shërbimet e ueb-orientuara në kuadër të administratës publike pavarësisht teknologjisë së aplikuar dhe platformës.
- **I dizajnuar** - Pamje e pranueshme vizuale dhe me dizajn atraktiv për gjithë sistemin.

1.3. Rëndësia e SIM

Sistemi i Informacionit Mjedisor është i rëndësishëm sepse mundëson:

- Përpunimin e informacionin nga burim kryesor më i afërt i të dhënave,
- Mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve në të njëjtën kohë, duke e bërë atë të disponueshme për subjektet e tjera dhe përdoruesit për qëllimet e tyre,
- Përmirësimin dhe integrimin e sistemeve ekzistuese të mbledhjes së të dhënave dhe informatave,
- Qasje të lehtë në të dhëna dhe informata me qëllim të ndërmarrjes së masave për mbrojtjen e mjedisit, duke vlerësuar rezultatet e këtyre masave dhe dhënien e informacionit mbi gjendjen e mjedisit për publikun,
- Mbështetjen e nevojshme teknike dhe shkencore për palët dhe institucionet,
- Zbatimi i mjeteve teknike (softuerë) uniforme, standardet e regjistrimit dhe procedurat e transferimit të të dhënave,
- Ndërveprimet teknike (normat dhe standardet për lidhjen e sistemeve kompjuterike dhe shërbime), semantik (njohja e të dhënave) dhe nivelit të procesit (që përcaktojnë objektivat, proceset e modelimit dhe bashkëpunimin në mes të subjekteve raportuese), zbatimin e standardeve teknike kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Hartimin më të shpejtë dhe më efikas të raporteve, analizave dhe studimeve për gjendjen e mjedisit,

- Mundëson vendimmarrjen dhe planifikim më të lehtë nga politikë-bërësit e niveleve të ndryshme,
- Rrite efikasitetin dhe nivelin e bashkëpunimit në mes palëve dhe institucioneve,
- Kursen kohën, materialet teknike dhe resurset humane dhe
- Rrite transparencën për punën e institucioneve.

2. Baza ligjore për SIM

Baza ligjore për hartimin e programit për menaxhimin e Sistemit Informativ Mjedisor është e bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, në Udhëzimin administrativ për Sistemin Informativ Mjedisor dhe në ligjet tjera relevante.

Tabela 1: Baza Ligjore për hartimin e programit për menaxhimin e SIM

Akti ligjor apo nënligjor	Përshkrimi
Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit	**Neni 52-Sistemi i Informimit Mjedisor** 1. Me qëllim të identifikimit, klasifikimit, për-punimit, përcjelljes dhe evidentimit sa më efikas të resurseve natyrore, vlerave të natyrës si dhe menaxhimit të mjedisit në Kosovë, Ministria krijon, organizon dhe mbanë Sistemin Informativ Mjedisor. 2. SIM bënë mbledhjen, klasifikimin, mirëmbajtjen, prezantimin dhe shpërndarjen e të dhënave numerike, përshkruese dhe hapësinore për: cilësinë e mediumeve të mjedisit; përcjelljen e gjendjes së mjedisit; masat ligjore,administrative, organizative dhe strategjike; informatat shkencore-teknologjike për masat e planifikuara për parandalimin e ndotjes; shkëmbimin e informatave me sistemet tjera informative etj. 3. SIM mundëson qasje në informata sistemeve tjera informative dhe harmonizon te gjitha informatat relevante në nivel të Kosovës dhe në nivelin ndërkombëtar. 4. Ministria me akt nënligjor, përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së SIM, metodologjinë, strukturën, bazat e përbashkëta, kategoritë dhe nivelin e grumbullimit të të dhënave, si dhe përmbajtjen e informacionit me të cilën informohet publiku rregullisht dhe detyrimisht.
Ligji Nr. 02/L-30 për mbeturinave	**Neni 14 pika d:** Ministria krijon bazën e shënimeve dhe sistemin informativ për administrimin e mbeturinave.
Ligji nr. 04/L-197 për kemikate	**Neni 15 - Sistemi informues për kimikatet** 1. Shkëmbimi i informacioneve me institucionet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për kimikatet bëhet duke u bazuar në dispozitat e dokumenteve të ratifikuara nga organi kompetent i Republikës së Kosovës. 2. Mbledhja, përpunimi, ruajtja dhe shkëmbimi i informacioneve me institucionet vendore për kimikatet është detyrë e Ministrisë, duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji lidhur me detyrimet për informim mbi kimikatet. 3. Ministria informon publikun dhe autoritetet përkatëse për rreziqet që mund të rrjedhin nga përdorimi I substancave dhe përzierjeve të rrezikshme dhe të rekomandojë marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e rrezikut. 4. Ministria nxjerr dhe publikon udhëzime teknike për nevojat e informimit të publikut dhe publikon regjistrat e substancave dhe përzierjeve që janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Ligji NR. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	**Neni 72** Instituti për Mbrojtjen e Natyrës mban sistemin informativ e të dhënave të mbrojtjes së natyrës si pjesë e sistemit të përbashkët informativ të MMPH, sipas standardeve dhe detyrimeve ndërkombëtare të pranuara.
Ligji nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	**Neni 25 Informimi i publikut** 1. Ministria, siguron që informatat e përditësuara për përqendrimin e materieve ndotëse në ajër të jenë në dispozicion të publikut dhe organizatave të interesuara. 2. Informimi i publikut bëhet se paku një herë në muaj përmes mediave elektronike dhe të shkruara. **Neni 26 Shkëmbimi i informatave** 1. Ministria shkëmben informatat për cilësinë e ajrit dhe emisionet me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet tjera në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare. 2. Mënyrën dhe afatet për shkëmbimin e informatave, me organet relevante, organizatat dhe BE, Ministria e bënë sipas akteve ligjore të BE.
Ligji Nr.04/ L-147 për ujërat e Kosovës	**Neni 81 - Sistemi Informativ ujor** 1. Sistemi Informativ Ujor përfshinë masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me regjistrimin, transferimin, mbrojtjen, shfrytëzimin e të dhënave si dhe çështjet e tjera me rëndësi për administrim me ujëra. 2. Sistemi informativ ujor përfshin të d hënat për: 2.1. sasinë dhe cilësinë e ujërave; 2.2. protokollin ujor dhe kadastrat e sistemit ujor; 2.3. protokollin e të gjitha lejeve; 2.4. regjistrin e substancave të shkarkuara nga bartësi i lejes ujore; 2.5. masat për rehabilitimin dhe programet për mbrojtjen e ujërave; 2.6. incidentet e dëmtimit të ujërave dhe aksidentet mjedisore; 2.7. regjistrin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme, në resurset ujore; 2.8. aktivitetet që janë të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin; 2.9. analizat e ndikimeve të materieve të rrezikshme; dhe 2.10. regjistrin më të dhënat e ndërtimeve, instalimeve apo deponive ekzistuese që janë të rrezikshme; 2.11. raportim për gjendjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. 3. Të gjithë personat dhe institucionet, janë të detyruara të ofrojnë të dhëna për ujërat Ministrisë dhe autoriteteve kompetente për ujëra. 4. Të dhënat e Sistemit informativ ujor janë publike dhe çdo kush mund të ketë qasje në to, përveç të dhënave që konsiderohen sekret shtetëror. 5. Ministria, me akt nënligjor, përcakton më hollësisht punën, mënyrën dhe çështjet tjera me rëndësi për sistemin informativ ujor.
Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma	**Neni 9** – Hartat Strategjike të Zhurmës Qeveria dhe komunat duhet të hartojnë: Hartën strategjike të

	zhurmës; Hartat strategjike të zhurmës nga paragrafi 1 i këtij neni janë pjesë përbërëse e sistemit informativ të mbrojtjes së mjedisit të Kosovës dhe paraqesin bazë profesionale për hartimin e planeve hapësinore.
Ligji Nr.03/L-043, për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes	Neni 17-Regjistri i informatave për lejet e lëshuara. -Ministria mbanë Regjistrin e informatave për lejet e lëshuara sipas këtij ligji. -Kur informata nuk përfshihet në Regjistër, atëherë në Regjistër duhet të futen një përmbledhje e informatave. -Ministria siguron qasje të lirë të publikut në të gjitha kohërat e arsyeshme dhe pa asnjë pagesë.
Udhëzimi administrativ nr. 17/2013, për kadastrin e shkarkimeve të ndotësve mjedis	Neni 25- Mënyra e dorëzimit të të dhënave nga operatorët, Neni 28- Mënyra e përpunimit të të dhënave nga AMMK, Neni 29- Sigurimi dhe kontrolli i cilësisë së të dhënave dhe Nenet 30 e 31-Afati dhe mënyra e informimit të publikut.

Programi për menaxhimin e SIM, është i mbështetur dhe është në funksion të zbatimit edhe të Strategjive, Planeve dhe Programeve relevante për sektorin e mjedisit.

Tabela 2 : Strategjitë, Planet dhe Programet në sektorin e mjedisit dhe sektorët relevante për SIM

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Institucioni përgjegjës për zbatim
Strategjia Mjedisore e Kosovës dhe Plani Kombëtar i Veprimit Mjedisorë (Rishikimi dhe azhurnimi)	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet	2011-2020	Aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit	2013-2017	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani i veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2017	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2014-2024	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Draft Strategjia Shtetërore e Ujërave	2017-2026	Dokumenti është proceduar për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Programi i Monitorimit të Ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	2014-2015	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani Hapësinor i Kosovës-Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës	2010-2020+	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia e Energjisë së Kosovës	2009-2018	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtritshme të Energjisë	2013-2020	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Plani Kombëtarë për Efiçencë të Energjisë	2013-2015	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Strategjia e Zhvillimit të Pylltarisë	2010-2020	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Strategjia për Konsolidimin e tokës	2010-2020	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Kosova ende nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe as e Bashkimit Evropian. Aktualisht ajo nuk ka obligime për përmbushjen e Konventave, Protokolleve dhe Direktivave dhe marrëveshjeve tjera ndërkombëtare, mirëpo meqenëse është e përcaktuar në rrugën e integrimeve Evropiane dhe anëtarësimit në OKB dhe në institucionet vartëse të saj, atëherë duhet marrë për bazë edhe legjislacionin dhe obligimet ndërkombëtare që ndërlidhen me Sistemin Informativ Mjedisor.

Konventat ndërkombëtare me rendësi për SIM janë:

- Konventa e UN për Ndryshimet Klimatike-UNFCC (1992)
- Konventa e UN për Diversitetin Biologjik (1993)
- Konventa e Aarhusit- Konventa e UNECE për Qasje në Informim, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe dhe Qasje në Drejtësi për çështje mjedisore (1998).
- Konventa e Stokholmit- Konventa e OKB për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga ndotësit e qëndrueshëm organik (1995).
- Konventa LRTAP- Konventa e UNECE për ndotje ndërkufitare të ajrit me rreze të gjatë veprimi (1979.)

Protokollet ndërkombëtare më rëndësi për SIM janë:

- Protokolli i Montrealit - Protokoli i OKB-së, për Substancat që hollojnë shtresën e Ozonit (1989).
- Protokolli i UNECE për PRTR- Regjistrin e Shkarkimeve dhe Ndotësve në Mjedis (2009).

Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian më Rëndësi për SIM janë:

- Direktiva 2003/4/EC, për qasje në informata mjedisore (2003).
- Direktiva 2008/50/EC, për cilësinë e ajrit ambiental dhe ajër të pastër (2008).
- Direktiva 1996/62/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit (Direktiva Kornizë për Cilësi të ajrit)(1996).
- Rregullorja Nr.401/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për Agjencinë ne Mjedisit të Evropës dhe për Rrjetin Mjedisor Evropian për Informim dhe Vëzhgim. (2009).
- Rregullorja (EC) 166/2006 në lidhje me themelimin e Regjistrit Evropian të Shkarkimeve dhe Ndotësve (E-PRTR) (2006).
- Direktiva 2007/2/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, për themelimin e Infrastrukturës për të dhëna hapësinore për Komunitetin Evropian (INSPIRE) (2007).
- Komunikimi SEC (2008) 111 dhe SEC (2008) 112, nga Komisioni Evropian për Këshillin dhe Parlamentin Evropian, për themelimin e Sistemit të Përbashkët për Informim Mjedisor (SEIS).

3. Struktura dhe organizimi i SIM

3.1. Grupet themelore të SIM

SIM është i organizuar në këto grupe themelore:

- Përbërësit (mediumet) mjedisor,
- Presionet sektoriale në mjedis,
- Ndikimet në shëndetin dhe sigurinë e njerëzve,
- Reagimet e shoqërisë ose masat dhe veprimet e ndërmarra.

Në kuadër të secilit nga këto grupet themelore janë të përfshira grupet tematike dhe nëngrupet të cilat e përbëjnë tërësinë e Sistemit Informativ Mjedisor. (Tabela 3)

Kjo strukturë e Sistemit Informativ Mjedisor është e përshkruar në nenin 4 pika të të Udhëzimit Administrative për Sistemin e Informimit Mjedisor dhe në shtojcën përkatëse të këtij udhëzimi.

Gjithashtu kjo strukturë është përshtatur edhe sipas nevojave të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave mjedisore me Agjencitë e Mjedisit të Evropës (AME-EEA) dhe me Rrjetin Evropian për Informim dhe Vëzhgim (RREIV-EIONET).

Tabela 3: Grupet themelore, grupet dhe nëngrupet tematike të SIM

Grupet themelore të SIM	Grupet tematike	Nëngrupet tematike
Përbërësit (mediumet) mjedisor	Ajri	Cilësia e ajrit
		Ndryshimet klimatike
	Uji	Cilësia e Ujërave
		Sasia e Ujërave
	Natyra	Zonat e Mbrojtura
		Biodiversiteti
	Toka/Dheu	Gjeportali
		Përdorimi i tokës (Land Use)
		Mbulushmëria e tokës (Land Cover)
Presionet (ndikimet) sektoriale	Mbeturinat dhe Kemikatet	Menaxhimi i Mbeturinave
		Menaxhimi i Kemikateve
	Bujqësia dhe Pylltaria	Bujqësia
		Pylltaria
		Peshkataria dhe Akuakultura
	Energjia dhe Industria	Energjetika
		Industria
	Transporti dhe Turizmi	Transporti dhe Trafiku
		Turizmi dhe Rekreacioni
Ndikimet në shëndetin	Shëndeti	Zhurma

publik		Ndikimi i ndotjes në shëndet
		Të dhënat socio-ekonomike
	Siguria mjedisore	Emergjencat natyrore
		Siguria bërthamore dhe rrezatimi jonizues
Reagimet e Shoqërisë	Aspekte te përgjithshme mjedisore	Ligjet , udhëzimet administrative dhe rregulloret
		Strategjitë dhe Planet mjedisore
		Raporte dhe Studime
		Projekte

Organizimi i tillës i strukturës së SIM është po ashtu i bazuar edhe në konceptin analitik DPSIR.

Ky model analitik mundëson organizimin e informacionit dhe integrimin e elementeve socio-ekonomike dhe mjedisore, duke adresuar marrëdhëniet ndërmjet pesë kategorive të treguesve: Forcat shtytëse (siç janë: prodhimtaria bujqësore, prodhimi industrial, teknologjia prodhuese etj.), Presionet në mjedis (si: emisionet në ujë, ajër dhe tokë), të cilat ndikojnë në keqësimin e gjendjes së mjedisit (p.sh., përqendrimin e metaleve të rënda në tokë, ngritjen e temperaturave mesatare globale), të cilat më pastaj ndikojnë duke imponuar kështu përgjigje ose reagim të institucioneve përkatëse për marrjen e masave të duhura (masa legjislative, taksa, programe mjedisore për hulumtime e kërkime etj). (Figura 1).




Figura 1: Korniza analitike DPSIR

Kjo mënyrë e organizimit të Sistemit Informativ Mjedisor po ashtu mundëson ofrimin e qasjes më të lehtë dhe shkëmbimin e të dhënave në mes të shfrytëzuesve të të dhënave dhe atyre që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna mjedisore.

Sistemi informativ Mjedisor është edhe në funksion të automatizimit dhe digjitalizimit të procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave që mundëson shkëmbim më të sigurte, më racional, më efikas, më të shpejtë dhe më pak të kushtueshëm.

Struktura skematike e Sistemit Informativ Mjedisor është e prezantuar në shtojcën 1 të këtij dokumenti.

3.2. Të dhënat dhe informatat për SIM

Me qëllim të sigurimit të informatave dhe të dhënave për vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe përbërësve të tij, të vlefshme për Sistemin Informativ Mjedisor, të dhënat mblidhen nga sistemi i monitorimit të gjendjes së mjedisit. (tabela 4)

Tabela 4 : Sistemi aktual i monitorimit të mjedisit në Kosovë

Lloji i monitorimit	Përbërja e rrjetit monitorues	Frekuenca e monitorimit	Parametrat/treguesit qe monitorohet
Monitorimi i cilësisë së ajrit	11 stacione automatike dhe 1 stacion mobil	Matje kontinuale (24/7)	Dyoksidi i Sulfurit SO_2, Monoksidi i Karbonit CO, Dyoksidi i Azotit NO_2, Ozoni O_3, Grimcat e Suspenduara PM10, Grimcat e Suspenduara PM 2.5.
Monitorimi i cilësisë së ujerave te lumenjve (ujerat sipërfaqësore)	54 vendmostrime ne 4 Pellgje lumore (23 Drini i Bardhë, 18 Ibri, 6 Morava e Binçës dhe 7 Lepenci)	18 vendmostrime janë referente dhe monitorimi bëhet 2 herë në vit, ndërsa në 36 vendmostrime tjera monitorimi bëhet në baza mujore	10 parametra fizik, 39 parametra kimik dhe 8 metale të rënda.
Monitorimi i sasisë se ujerave te lumenjve –rrjeti hidrometrik	22 stacione hidrometrike dhe 2 stacione për paralajmërim të rrezikut nga vërshimet	Tek stacionet hidrometrike niveli matet në mënyrë kontinuale (24/7) kurse prurjet 1-12 herë në vit, ndërsa tek stacionet për paralajmërim të rrezikut nga vërshimet matjet bëhen në kohë reale	Niveli (h), Prurja (Q) dhe profili i lumit

Monitorimi i gazrave serre	Përgatitja e inventarit te gazrave sere sipas sektorëve te IPCC	Përgatitja e inventarit ne baza vjetore	Gazrat e serrës (CO2,CH4, N2O, HFCs, PFCs, SF6.), nga keta sektorë: Energjia, Proceset Industriale dhe përdorimi i produkteve, Bujqësia, Pylltaria dhe përdorimi i tokave dhe Mbeturinat
Monitorimi i dheut/tokës	Monitorimi i ndotjes së tokave	Sipas programit të monitorimit nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe nga Instituti Bujqësor i Pejës	Prezenca e metaleve të rënda dhe e ndotësve organik në pikat e mostruara
Monitorimi i mbeturinave	Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes se deponive sanitare, regjionale, spitalore dhe deponive tjera	Vizita monitoruese se paku dy herë në vit	Menaxhimi, kompaktimi, mbulimi i mbeturinave si dhe menaxhimi i ujerave në deponi dhe ndikimet ne mjedis.
Vete monitorimi nga operatoret ekonomik	Monitorimi nga KEK, NewCo Feronikeli dhe Sharrcemi	Ditore, Mujore dhe periodike varësisht nga parametrat	Emisionet në ajër dhe ujë, shfrytëzimi i ujit, etj.
Monitorimi i zonave te mbrojtura	Monitorimi i rrjetit nacional të zonave te mbrojtura (170 zona të mbrojtura)	Se paku një here ne vit për secilën zonë monitorohet gjendja aktuale, ndërhyrjet ilegale, vlerat natyroret.	2 Parqe Kombëtare, 99 Monumente të natyrës, 2 Peizazhe te mbrojtura, 1 Park regjional dhe 1 zone e rëndësishme e zogjve
Monitorimi i biodiversitetit (llojeve të rralla te florës dhe faunës)	Monitorimi i llojeve të rrezikuara të faunës përmes kamerave kurth	Kamerat regjistrojnë lëvizjet e llojeve kafshëve dhe ato herë pas here kontrollohen për regjistrimet që kanë kapur ato	Rrëqebulli, dhia e egër, ariu i murrmë, pulegra etj.
Monitorimi i kushteve meteorologjike	5 stacione meteorologjike/ klimatologjike	5 stacione meteorologjike, klimatologjike/ bëjnë matje 3-6 here ne dite. Dy stacione meteorologjike/matje ne kohe reale.	Temperatura e ajrit, shtypja e ajrit, lagështia, drejtimi dhe shpejtësia e erës, dukshmëria, insolacioni, reshjet, lartësia dhe tipet e reve, parashikimi i motit.

Metodologjia e mbledhjes, përpunimit dhe vlerësimit të të dhënave si dhe afati kohor i ofrimit të të dhënave është e përcaktuar sipas listës kombëtare të treguesve mjedisor dhe sipas nenit 8 të Udhëzimit Administrative për Sistemin Informativ Mjedisor ku mes tjerash është e specifikuar që:

- ✓ Personat fizik dhe juridik sigurojnë mbledhjen e të dhënave dhe informative; verifikimin dhe sigurimin e cilësisë së të dhënave; si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe ndërveprimin e sistemit të informimi apo nënsistemit.
- ✓ Personat fizik dhe juridik detyrohen për të siguruar qasje të lehtë në të dhënat dhe informatat dhe përdorimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të informimit.
- ✓ Personat fizik dhe juridik janë përgjegjës për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave dhe informatave për të cilat ata janë përgjegjës dhe kanë obligim ligjor
- ✓ Personat fizik dhe juridik janë përgjegjës për përcaktimin e nivelit të disponueshmërisë së të dhënave dhe informatave.

Në masë të konsiderueshme mbledhja,përpunimi dhe raportimi i të dhënave është orientuar edhe nga indikatorëve (treguesve) mjedisor të cilët janë më të përshtatshëm për vlerësimin e gjendjes së mjedisit. Indikatorët e zgjedhur duhet të kenë bazë shkencore dhe të jenë të kapshëm nga të gjithë ata që do të shërbehen me të dhënat nga Sistemi Informativ Mjedisor.

Treguesit Mjedisor- Treguesi mjedisore është një parametër, ose një vlerë që rrjedhë nga një parametër, që tregon ose jep informacion për një dukuri të caktuar ose përshkruan gjendjen e mjedisit, dhe ka një shtrirje kufizuese të lidhur direkt me ndonjë vlerë të caktuar parametrike. Ndryshe treguesit mjedisor **j**anë masa fizike, kimike, biologjike dhe socio-ekonomike që më së miri përfaqësojnë elementet kryesore të një kompleksi të ekosistemeve apo një çështje mjedisore. Pra, treguesi mjedisor është një vlerë e përcjellur që prezanton një dukuri të monitoruar.

Indikatorët zakonisht prezantojnë trendët e zhvillimeve mjedisore. Ata duhet të jenë informata të thjeshtëzuara qe ndihmojnë te kuptohen fenomene komplekse. Për të komunikuar, ne mënyre shumë te qartë, një realitet te thjeshtëzuar, treguesit (indikatori) duhet:

- Të jetë atraktiv për syrin dhe duhet të jetë me qasje të lehte;
- Të jetë i lehtë për t'u interpretuar dhe të provokoj veprim (lexim, hulumtim, pyetje);
- Të jetë reprezentativ dhe të tregoj zhvillimet në një interval relevant kohor;
- Të jetë i shoqëruar me vlera referente dhe i krahasueshëm në aspekt kohor;
- Të jetë i shoqëruar me shpjegime për ndryshimet;

- Të jetë i krahasueshëm e indikatorë të tjerë që tregojnë fusha të ngjashme;
- Të jetë i bazuar shkencërisht apo të jetë i bazuar në statistika të besueshme;

Lista e treguesve mjedisor sipas sektorëve përkatës, kodi i treguesve dhe lloji i treguesit është e prezantuar në tabelën 5.

Tabela 5: Lista e treguesve mjedisor

Sektori	Kodi i treguesit	Emri i treguesit	Lloji i treguesit sipas DPSIR
Treguesit mjedisor të ajrit	A01	Cilësia e ajrit në zonat urbane	Tregues i gjendjes
	A02	Emisionet e gazrave acidifikuese	Tregues i presionit
	A03	Emisionet nga prekursorët (dëmtuesit) e ozonit	Tregues i presionit
	A04	Emisionet e grimcave primare të suspenduara dhe prekursorët e grimcave sekondare të suspenduara	Tregues i gjendjes
Treguesit mjedisor të ndryshimeve klimatike	NK01	Temperatura vjetore e ajrit	Tregues i gjendjes
	NK02	Sasia vjetore e reshjeve	Tregues i gjendjes
	NK 03	Përdorimi i substancave që dëmtojnë shtresën e Ozonit	Tregues i presionit
	NK 04	Trendi i emisioneve të gazrave serrë	Tregues i presionit
	NK 05	Projeksionet e emisioneve të gazrave serrë	Tregues i presionit
Treguesit mjedisor të ujit	U01	Nutrientet ne ujërat sipërfaqësor	Tregues i gjendjes
	U02	Shpenzimi biokimik i oksigjenit	Tregues i gjendjes
	U03	Indeksi i kualitetit të ujërave sipërfaqësor	Tregues i gjendjes
	U04	Kualiteti i ujit për pije	Tregues i gjendjes
	U05	Përdorimi i resurseve të ujërave të ëmbla	Tregues i presionit
	U06	Humbjet e ujit	Tregues i reagimit
	U07	Qasja në ujësjellësit publik	Tregues i reagimit
	U08	Qasja në kanalizimet publike	Tregues i reagimit
